



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 nen c) dhe d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nën c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 1, të Statutit të Komunës së Klinës, mars/2010, me propozimin e Kryetarit të Komunës për Ndryshim-plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të Punës së Organizatave të biznesit në Komunën e Klinës /tetor 2011, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e V-të të rregullt, të mbajtur më 31.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

Për Inicimin e procedurës për ndryshim-plotësim të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Klinës
(të miratuar, më 28.10.2011).

- I. Miratohet Vendimi për Inicimin e procedurës për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Klinës (të miratuar, më 28.10.2011).
 - II. Vendimi si në pikën 1 miratohet me arsyen e ndryshimeve të nevojshme të Rregullores se lartshënuar, si në nenin 10 paragrafi 10.1 dhe 10.2, si dhe Ndryshimeve tjera që derivojnë nga konsultimet dhe debatet publike, grupet e Interesit, si dhe vet Komisioni për hartimin profesional të Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të rregullores lëndore.
 - III. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi konform nenit 81 të LVL dhe nenit 17 të Rregullores së MAP-së, nr.01/2017.
- Me këtë Vendim të njoftohet:
MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra Ligjore, Drejtoria e Inspektoratit, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 060-22788 2019
Klinë, më 07.10.2019 2019



Kryesuesi,
Fadil Gashi